



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr.920/7 Prot

Tiranë, më 08.11.2023

VENDIM

Nr.50, datë 08.11.2023

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 9/1, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 920 Prot., datë 11.05.2023, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik/Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesi, në cilësinë e kërkuarit, nëpërmjet kërkesës datë 13.04.2023, depozituar në adresën elektronike [info@azhbr.gov.al](mailto:info@azhbr.gov.al), ka kërkuar t’i vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni, në lidhje me:

1. Cili është synimi i Programit IPARD?
2. Si u krijua Programi IPARD?
3. Cilat janë objektivat e Programit IPARD?
4. Çfarë tematikash/fushash mbështet Programi IPARD?
5. A ka një sistem ndarje, pikëzimi apo grupimi për kategoritë e përfituesve në çdo thirrje? Nëse po, na e vendosni në dispozicion;
6. Si realizohet informimi i publikut për thirrjet e Programit IPARD?
7. Si mbështeten fermerët gjatë procesit të aplikimit?
8. Çfarë kushtet dhe dokumentacioni duhet të plotësojnë aplikuesit për të përfituar?
9. Si vlerësohen/filtrohen aplikimet, lidhur me kriteret e vlerësimit?

10. Çfarë mekanizmesh përdorni për të shmangur përfitimin e fondeve nga persona të lidhur me krimin e organizuar apo me politikën, zyrtarë që mund të jenë në kushtet e konfliktit të interesit?
11. Na vendosni në dispozicion shumat e grandeve të shpërndara për secilën thirrje ndër vite, specifikuar me: a. Shuma e planifikuar; b. Shuma e alokuar; c. Shuma e mbetur në fund.
12. Specifikoni shumat e përfituara për secilën target-kategori në secilën thirrje ndër vite;
13. Si planfikohet të vijojë programi në terma narrativë dhe financiarë?
14. Si sigurohet kontrolli i cilësisë së zbatimit të projekteve fituese?
15. A keni ndërmarrë kontrole, verifikime për projektet fituese në thirrjet ndër vite? Nëse po, na i vendosni në dispozicion rezultatet;
16. Cila është struktura e punonjësve të AZHBR-së që i dedikohen zbatimit të Programit IPARD?
17. Specifikoni rolet dhe numrin e punonjësve për secilin pozicion, sektor;
18. Na vendosni në dispozicion listat e subjekteve përfituese nga secila thirrje gjatë Programit IPARD, duke specifikuar emrin e subjektit përfitues, sektorin, adresën, shumën e përfituar, etj.
19. A ka pasur raste kur subjekteve i është kërkuar kthimi i grandit pas, si pasojë e mospërbushjes së zbatimit të tij sipas koncept-idesë së miratuar? - Nëse po, na vendosni në dispozicion detajet sipas rasteve;
20. Na vendosni në dispozicion për secilën thirrje ndër vite, numrin e aplikimeve, numrin e aplikimeve të kualifikuara dhe numrin e aplikimeve të skualifikuara;
21. Si i trajton AZHBR ankesat?
22. Sa ankesa ka pasur përgjatë Programit IPARD?
23. Specifikojini ankesat sipas secilës thirrje dhe na vendosni në dispozicion një kopje të secilës prej tyre;
24. Si e ka vlerësuar AZHBR realizimin e Programit IPARD?
25. A keni ndërmarrë kontrole, auditime të brendshme/jashtme për programin? - Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të gjetjeve dhe raporteve të hartuara;
26. A jeni përfshirë në procese gjyqësore si palë paditëse apo e paditur për projekte apo procedura që lidhen me Programin IPARD? - Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të secilës prej rasteve;
27. Sa prej subjekteve përfituese janë persona fizik, sa në formën e organizimit sh. k., sh. a. dhe forma të tjera?
28. A keni mbështetur familje fermere dhe individë me kode fermeri? - Nëse po na vendosni në dispozicion numrin e tyre sipas secilës thirrje?
29. Përse është konceptuar që të përfitojnë vetëm bizneset dhe jo format e tjera të organizimit, si Organizatat Jo - Qeveritare?
30. A keni referuar në agjencitë ligjzbatuese (policia, prokuroria etj.) subjekte apo persona përfitues nga Programi IPARD? - Nëse po, na informoni me detaje për secilin rast.

Pas përgjigjeve të dhëna nga Autoriteti Publik, nëpërmjet e-mail-eve datë 26.04.2023 dhe datë 02.05.2023, ankuesi me pretendimin se nuk ka marrë informacionin e plotë sipas pikave të kërkesës për informacion, ka paraqitur ankim pranë Komisionerit, duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit si dhe urdhërimin e dhënies së informacionit/dokumentacionit të plotë nga Autoriteti Publik.

Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, Komisioneri, me shkresën nr. 920/1 prot., datë 15.05.2023, ka kërkuar nga Autoriteti Publik qëndrimin në lidhje me pretendimin e ngritur nga ankuesi, si dhe sqarime për zotërimin e informacionit/dokumentacionit të kërkuar, duke rivlerësuar në këtë mënyrë kërkesën për informacion, brenda datës 19.05.2023.

Autoriteti Publik me shkresën nr. 1935/1 Prot., datë 19.05.2023, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 920/2 Port., datë 22.05.2023, ka kthyer përgjigje duke sqaruar: “*Implementimi i programit IPARD, procedurat e përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve, bazohen në Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II), në Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural” (IPARD), si dhe në Udhëzimin për Aplikantët e Programit IPARD II, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të AZHBR. Referuar nenit 23 të Marrëveshjes Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II). d) Strukturat operuese garantojnë informimin e marrësit të asistencës se do të figurojë në listën e publikuar për këtë qëllim. Të dhënat personale që shpallen në këtë listë trajtohen në përputhje me kërkesat e Rregullores (KE) Nr. 45/2001 dhe duke respektuar kërkesat mbi konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave. Gjithashtu, referuar Nenit 29 “Informimi, publiciteti dhe transparencë” të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit*

për asistencën e para-anëtarësimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural" (IPARD):  
(1) Shqipëria jep informacion dhe bën publicitet të programit IPARD II dhe të kontributit të BE-së, sipas Shtojcës 8. Grupi i synuar për t'u informuar është publiku i gjerë. Informacioni nënvizon rolin e BE-së dhe garanton transparencë të asistencës së BE-së.  
(2) Me qëllim që të garantohet transparencë për mbështetjen e IPARD, Agjencia IPARD është përgjegjëse për publikimin e listës së operacioneve dhe përfituesve të asistencës IPA II, sipas kushteve të përcaktuara në nenin 23, pika 2 të MK-së. Publikimi bëhet në format Excel, që mundëson ndarjen, kërkimin, nxjerrjen, krahasimin dhe publikimin e lehtë në internet të të dhënave, për shembull në format CSV apo XML. Lista e operacioneve duhet të gjendet në faqen e internetit apo në portalin e internetit. Informacioni minimal që duhet të përmbajë lista e operacioneve është përcaktuar në Shtojcën 8 të kësaj Marrëveshjeje. Lista e operacioneve që i referohet nenit 29 (3) përmban fushat e të dhënave të mëposhtme:

- emri i përfituesit (vetëm i subjekteve juridike; jo i personave fizikë);
- emri i operacionit; - përmbledhje e operacionit;
- data e fillimit të operacionit;
- data e përfundimit të operacionit (data e parashikuar për përfundimin fizik ose zbatimin e plotë të operacionit);
- shpenzimet totale të pranueshme që janë përcaktuar për operacionin;
- shkalla e bashkëfinancimit të Bashkimit Evropian, sipas aksit prioritar;
- kodi postar i operacionit; ose një indikator tjetër i përshtatshëm për vendndodhjen;
- vendi;
- emri i kategorisë së ndërhyrjes për operacionin;
- data e përditësimit të fundit të listës së operacioneve.

Gjithashtu, ankuesit i janë komunikuar linqet, ku mund të aksesonte informacionin për secilën nga thirrjet e programit IPARD II, objektivat e programit IPARD, fondin në kuadër të programit IPARD II etj. Për secilën thirrje, janë të publikuara, udhëzuesi i cili përcakton procedurat, kriteret, dokumentet masat mbështetëse, përfituesit potenciale; listat e përfituesve; fondet në dispozicion, për secilën thirrje; njoftimet e hapjes së thirrjeve, etj. Për sa i përket, kopjeve të dokumentacionit, të kërkuar, me përjashtim të atyre që janë të publikuara në faqen zyrtare (Siç janë Marrëveshjet Kuadër/Sektoriale, Programi IPARD II, Ligjet, VKM, Udhëzimet, lista e përfituesve, vendimet, njoftimet) pjesa tjetër nuk mund t'iu vendoset në dispozicion pasi kufizohen nga neni 17 i ligjit, "Për të drejtën e informimit".

Në bazën ligjore, të referuar në faqen zyrtare web të AZHBR, si dhe dokumentet e publikuara në faqen zyrtare, gjendet i gjithë informacioni i kërkuar. Dokumentet e publikuara në faqen zyrtare, përmbajnë informacion lidhur me: objektivat e programit IPARD, ndarjen pikëzimin e aplikimeve, informimi i publikut të gjere lidhur me hapjen e thirrjeve per aplikime, si mbështeten fermerët për të aplikuar (konsulentë private, agropikat), mekanizmat e shmangies se konfliktit te interesit, shumat e alokuara për çdo thirrje, shumat e përfituara për cdo subjekt, kontrolli i aplikimeve, monitorimi i tyre, subjekte përfitues të cdo thirrje, si dhe forma e organizimit te tyre (PF, SHPK, SHA, SHBB), cilat kategori subjektsh përfitojnë nga Programi IPARD.

Në asnjë moment kërkuesit nuk i është mohuar e drejta për t'u pajisur me informacion. Pra, nuk është cenuar në të drejtën e tij për informim, por sipas ligjit për të drejtën e informimit i janë vendosur në dispozicion të gjitha linqet ku mund të aksesonte lehtësisht informacionin publik. E drejta, e informimit nuk është një e drejtë, absolute, ajo ka kufirin e respektimit dhe kufizimet e saj. Kjo sepse tërësia e situatave është aq e shumëllojshme sa lind edhe nevoja për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë personat. Sipas parimeve të përgjithshme kushtetuese, kufizimi i çdo të drejte, përfshirë edhe të drejtën për informim, mund të bëhet vetëm sipas kriterëve të parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës: - Vetëm me ligj (formalo-material): kjo nënkupton që asnjë organ tjetër përveç Kuvendit, i cili është autoriteti i vetëm që nxjerr ligje, nuk ka të drejtë të nxjerrë rregulla që parashikojnë kufizime të kësaj të drejte. Shembuj të ligjeve të këtillë janë ligji "Për sekretin shtetëror" apo edhe ai "Për mbrojtjen e të dhënave personale"; për të mundësuar përmbushjen e kërkesave të interesit publik ose për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve: si realizimi i të drejtës ashtu edhe kufizimi i saj kanë si pikë referimi interesin publik, nocion ky i cili, për shkak të natyrës së papërcaktuar që ka, mund të krijojë hapësira interpretimi të kufizimit që mund të bartë edhe e drejta për informim.

Në nenin 17, të ligjit "Për të drejtën e informimit, kufizohet e drejta e informimit, pikërisht për të mbrojtur të drejtat e të tjerëve, që nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre, për të bërë dokumentet dhe të dhënat (të cilat në mënyrë direkte ose indirekte bëjnë identifikimin e tyre) e tyre publike. Sipas nenit 35 të Kushtetutës askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhënat që lidhen me personin e tij. Ky nen thekson se personat nuk mund të detyrohen të japin informacione që konsiderohen personale. Sipas këtij neni, mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave të personit pa pëlqimin e tij është e ndaluar, me përjashtim të rasteve që lidhen me interesa publike madhore.

Siç është theksuar, e drejta për t'u informuar është e kufizueshme. Kufizimi realizohet sipas kërkesave të Kushtetutës, parashikuar në nenin 17 të saj. Kufizimet themelore vijnë si rezultati nevojës për të mbrojtur të drejtën për privatësi apo edhe për të mbrojtur interesin publik si për shembull sigurinë e vendit. Kështu, Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", synon të balancojë të drejtën e publikut për t'u njohur me të dhënat personale të një individi si dhe të drejtën e privatësisë. Sipas nenit 2 të ligjit, të dhëna personale janë çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm. Elementet me të cilat realizohet identifikimi i një personi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, janë numrat e identitetit ose faktorë të tjerë të veçantë fizikë, psikologjikë, ekonomikë, socialë, kulturorë etj. Të tilla mund të jenë: emri, mbiemri, atësia, mëmësia, datëlindja, vendlindja, vendbanimi, arsimi, profesioni, titulli shkencor, kombësia, shtetësia, gjendja civile, apo edhe referenca për individët në dokumente, në faqe dhe rrjete të ndryshme të internetit, përfshirë mesazhe me e-mail, fotografitë e individëve, regjistrimet e të dhënave në telefonin celular e fiks, informacione për llogaritë bankare apo për policat e tyre të sigurimit, të dhënat në rrjetet tregtare, regjistrimet tek mjeku, në aktet e sigurimeve shoqërore, në aktet gjyqësore e të policisë, etj., Dokumentacioni i kërkuar për kopje të ankesave të aplikanteve, dhe raporteve të kontrollit, nuk mund t'i vendosen në dispozicion palëve të treta, që nuk janë pjesë e procesit të aplikimit, apo të kontratave, me përjashtim të atyre të përcaktuara në Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian që përcakton dispozitat e



*menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural” (IPARD), si dhe organeve të drejtësisë (gjykata, prokuroria).*

*Implementimi i programit IPARD, procedurat e përzgjedhjes dhe aprovimit të projekteve, bazohen në Marrëveshjen Kuadër, ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian për rregullat e zbatimit të asistencës financiare të BE për Shqipërinë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit (IPA II), në Marrëveshjen Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Europian që përcakton dispozitat e menaxhimit dhe zbatimit të asistencës financiare të BE për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për asistencën e para-anëtarësimit në fushën “Bujqësia dhe Zhvillimi Rural” (IPARD), si dhe në Udhëzimin për Aplikantët e Programit IPARD II, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të AZHBR. Në bazën ligjore të sipërpërmendur gjeni informacion për krijimin e programit IPARD, objektivat, synimin e programit, masat mbështetëse, procedurat, kriteret e përfitimit të mbështetjes financiare, dokumentacioni që duhet plotësuar për secilën masë mbështetëse, strukturat operuese/audituese të programit, kontrollet administrative që ndërmerren nga Agjencia për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural; [www.azhbr.gov.al/](http://www.azhbr.gov.al/) <https://azhbr.gov.al/programi-ipard>.*

Ankuesi, pas përgjigjes së sipërcituar ka vijuar ankimin me emailin e regjistruar me nr.920/4 Prot., datë 02.06.2023, duke kërkuar nga Komisioneri urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilin parashikohet se: “...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, bazuar dhe në nenin 87 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me shkresën nr. 920/5 Prot., datë 16.06.2023, Komisioneri ftoi palët në një seancë dëgjimore.

Seanca u zhvillua me prezencën e përfaqësueses së ankuesit dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik. Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi parashit pretendimet e depozituara mbi pikat e kërkesës për informacion, për të cilat nuk ka marrë informacion. Ndërkohë, nga ana e përfaqësuesve të Autoritetit Publik u rikonfirmua qëndrimi i mbajtur në kthim përgjigjet e vendosura në dispozicion të ankuesit dhe Komisionerit.

Pas seancës dëgjimore, nëpërmjet emailit datë 03.11.2023 ankuesi ka vijuar ankimin e regjistruar me nr. 920/6 Prot., datë 03.11.2023 duke kërkuar nga Komisioneri urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të pikave të kërkesës për informacion, konkretisht pika 15, 23, 25 dhe 26, me pretendimin se: “Referuar nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 1 dhe referuar Ligjit nr. 119/2014, "Për të Drejtën e Informimit", Neni 3 dhe Neni 17, pika 2 (dhe përshkrimeve se: "Pavarësisht nga sa parashikohet në paragrafin e parë, të pikës 2 të këtij neni, informacioni i kërkuar nuk

*refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij" dhe "Kufizimi mbi të drejtën e informimit, për shkak të interesit të parashikuar në pikën 2, shkronjat "d" dhe "dh", të këtij neni, nuk zbatohet kur të dhënat përkatëse janë fakte, analiza të fakteve, të dhëna teknike ose të dhëna statistikore"; Sjellim në vëmendje që ne jemi gazetarë dhe informacioni i kërkuar synon informimin publik dhe është në interesin e tij.*

Pas konsultimit të legjislacionit të posaçëm, parashtrimeve të paraqitura nga Autoriteti Publik dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i mbajtur nga ana e Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat dhe parimet e LDI.

Në shkronjën "a" të pikës 1 të nenit 2 të LDI parashikohet se: *"Autoritet publik" është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njëjësive të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj".*

Në kuptim të këtij parashikimi, Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *"1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.*

Nga shqyrtimi i çështjes, konstatohet se objekti i kërkesës për informacion lidhet me implementimin e programit IPARD, e konkretisht me rregullat e zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të instrumentit për Asistencën e Paraanëtarisimit në fushën "Bujqësia dhe Zhvillimi Rural".

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se: *"...Kopjet e raporteve të kontrolleve të kryera pranë aplikanteve të Programit IPARD II dhe kopjet e ankesave të aplikantëve, janë një e dhënë konfidenciale ndërmjet kontraktuesit dhe përfituesit dhe nuk mund t'ju vihet në dispozicion palëve të treta, përveçse kur kërkohet nga gjykata. Aplikantët, japin pëlqim në deklaratën e tyre që pranojnë që të dhënat e tyre personale, si dhe dokumentacioni do t'i vendoset në dispozicion shërbimeve të Auditit të Brendshëm, Gjykatës Evropiane të Auditorëve, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit, si dhe organeve të drejtësisë, dhe jo personave të tretë",* Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron. Konstatohet se, Autoriteti Publik në argumentin e parashtruar për mos dhënie të informacionit, nuk ka bërë një analizë të mirëfilltë apo të argumentojë se si kjo e drejtë kufizohet, kur është e domosdoshme, propocionale, si dhe dëmin që mund t'u shkaktojë

palëve si pasojë e dhënies së informacionit të kërkuar, duke mos provuar në asnjë moment se mbi cilën dispozitë ligjore e mbështet qëndrimin e tij.

Referuar nenit 29 të Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë të përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian “Informimi, publiciteti dhe transparencë”, del qartë se burojnë një gamë detyrimesh vizibiliteti e transparencë dhe jo kufizuese. Detyrime të tilla kontraktore janë të përfshira në të gjithë marrëveshjet për grantime, subgrantime, financime apo mbështetje nga institucionet e BE-së, dhe janë të dhëna që bëhen publike nga zbatuesi i programeve si pjesë e kushteve të vizibilitetit të programeve, por në asnjë rast nuk janë penguese për përcjelljen e informacionit të mëtejshëm tek publiku. Për më tepër që edhe vetë BE ka qasje maksimale transparencë për sa i përket projekteve të financuara me fonde publike.

Sa i përket pretendimit se: *“Bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, e drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm: a) të drejtën për një jetë private;”* Komisioneri vlerëson se, ky pretendim nuk qëndron, pasi vetë rregullorja, por edhe pika 1, e nenit 3, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, përcakton se: *“Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social. Në këtë kuadër, të dhënat e subjekteve tregtare të regjistruar si person fizik ose juridik në bazë të legjislacionit përkatës tregtar, nuk konsiderohen si të dhëna personale dhe si të tilla nuk gëzojnë mbrojtje nga ligji i sipërcituar.*

Thënë kjo, në çdo rast, Autoriteti Publik duhet të kishte argumentuar moszbatimin e parashikimit në paragrafin e fundit të pikës 1 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij. Duke qenë se informacioni i kërkuar lidhet me fonde të dhëna nga Bashkimi Evropian dhe Qeveria Shqiptare si një mbështetje financiare për bujqësinë dhe zhvillimin rural, interesi publik për të aksesuar informacion/dokumentacion lidhur me mënyrën e përdorimit të fondeve të dhëna në këtë rast është i drejtëpërdrejtë dhe i lartë. Rrjedhimisht, ky dokumentacion, duhet të ishte bërë publik duke garantuar kështu njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se: *“...Raportet e auditimit nuk bëhen publike në referencë të nenit 16 të Ligjit Nr. 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, i ndryshuar, pasi audituesit e brendshëm kanë detyrimin: d) të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave, fakteve apo rasteve të gjetura gjatë kryerjes së auditimit apo të lidhur me të, si dhe të ruajnë dokumentet për çdo angazhim auditimi të kryer, bazuar në detyrimet, që rrjedhin nga ligjet në fuqi për të drejtat e përdorimit dhe të arkivimit të informacionit zyrtar”*, Komisioneri vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Ky parashikim nuk mund të aplikohet apriori nga ana e Autoritetit Publik, bazuar në shkronjën dh) të nenit 7 të LDI, çdo autoritet publik vë në dispozicion të publikut në faqen



e tij në internet “mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit”. Pra, informacioni i kërkuar bën pjesë në atë kategori informacioni i cili duhet t’i vihet në dispozicion publikut pa kërkesë. Rrjedhimisht, raportet e auditimit përbëjnë informacion publik dhe si të tilla duhet të vendosen në dispozicion të kërkuarit duke treguar kujdes në publikimin e të dhënave të personave të tjerë të cilët përmenden në mënyrë sporadike në këto raporte.

Lidhur me kërkimin e ankuesit në pikën 26 të kërkesës për informacion, (*A jeni përfshirë në procese gjyqësore si palë paditëse apo e paditur për projekte apo procedura që lidhen me Programin IPARD? - Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të secilës prej rasteve*), Komisioneri konstaton se arsyetimi i Autoritetit Publik gjen zbatim në gërmën dh), të nenit 17 të LDI, në të cilën parashikohet se: “*E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, propocionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e procesit gjyqësor*”. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se kjo pikë e kërkesës për informacion duhet rrëzuar, pasi dhënia e këtij informacioni mund të cenojë barazinë palëve në proces gjyqësor dhe mbarëvajtjen e tij.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dokumentacioni i kërkuar në pikat 15, 23 dhe 25 të kërkesës për informacion, në parim përbëjnë informacion publik bazuar në pikën 2, të nenit 2, të LDI sipas të cilës: “*informacion publik*” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”. Rrjedhimisht, ekzistenca e informacionit/dokumentacionit të mësipërm pavarësisht nëse është prodhuar apo administrohet nga Autoriteti Publik, ngarkon me përgjegjësi këtë të fundit, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të këtij ligji, i cili parashikon: “*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim*”.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike dhe çdo subjekti që ushtron funksione publike. Ndërkohë pika 3, e nenit 3 e LDI parashikon se: “*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*”.

Gjithashtu, kërkuari/ankuesi është gazetar, i cili synon informimin e opinionit publik mbi çështje lidhur me funksionimin e autoriteteve publike, duke i shërbyer në këtë mënyrë interesit të lartë publik. Ky qëndrim i Komisionerit, gjen mbështetje në jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në çështjen “*Társaság a Szabadságjogokért kundër Hungarisé*”, vlerësoi se, pengesat e krijuara, të cilat vështirësojnë aksesin në informacion me interes publik, mund të dekurajojnë punonjësit e medias ose në fusha të ndërlidhura me të, të

realizojnë punën e “mbikëqyrësit shoqërorë”, duke zvogëluar mundësitë e tyre për të ofruar informata të sakta dhe të besueshme.

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksonimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 10 dhe 12 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e pjesshëm të ankesës nr. 920 Prot., datë 11.05.2023, nga z. \_\_\_\_\_, kundër Autoritetit Publik, “Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të informacionit/dokumentacionit të kërkuar sipas kërkesës për informacion të datës 13.04.2023, konkretisht (15. A keni ndërmarrë kontrollë, verifikime për projektet fituese në thirrjet ndër vite? Nëse po, na i vendosni në dispozicion rezultatet; 23) Specifikojini ankesat sipas secilës thirrje dhe na vendosni në dispozicion një kopje të secilës prej tyre; 25). A keni ndërmarrë kontrollë, auditime të brendshme/jashtme për programin? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të gjetjeve dhe raporteve të hartuara), duke respektuar kufizimet në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit, i ndryshuar, brenda datës 15.11.2023.
3. Rrëzimin e ankesës për informacionin/dokumentacionin e kërkuar në pikën 26 të kërkesës për informacion datë 13.04.2023, konkretisht: (26. A jeni përfshirë në procese gjyqësore si palë paditëse apo e paditur për projekte apo procedura që lidhen me Programin IPARD? Nëse po, na vendosni në dispozicion një kopje të secilës prej rasteve).
4. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.
5. Ky vendim u shpall sot në datë 08.11.2023.

## **KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**